

Fjala e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil përpara Kuvendit të Shqipërisë

E nderuar Zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar Zonja e Zotërinj Deputetë,

Kam kënaqësinë t'Ju paraqes Raportin Vjetor të veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2021.

Në përmbajtjen e raportit të këtij viti kemi treguar si progresin që është arritur në fushën e administrimit të shërbimit civil, ashtu edhe problemet që hasen në këtë drejtim, duke u përpjekur që të tregojmë edhe rrugët e zgjidhjes së tyre.

Konkluzionet e arritura janë bazuar në analizën e të dhënave të administruara gjatë procesit të mbikëqyrjes, që është kryer nga Komisioneri nëpërmjet vizitave në subjekt, si edhe duke realizuar studime të aspekteve të ndryshme të administrimit, duke përdorur disa mënyra alternative, të tilla si:

- plotësimi dhe analiza e pyetësorëve, ku janë përfshirë pyetje të ndryshme, drejtuar target grupeve që veprojnë në fushën e shërbimit civil, që kanë lidhje me çështjet që do të vlerësohen;
- nëpërmjet administrimit dhe vlerësimit të të dhënave që janë dërguar nga institucionet, pas kërkesave konkrete të Komisionerit, sipas fushës ku është kryer studimi.

Studimet janë kryer: **a)** në fushën e vlerësimit të impaktit të ligjit për nëpunësin civil; **b)** në drejtim të situatës që ka lidhje me pozicionet e paplotësuara të punës në shërbimin civil, si dhe **c)** në drejtim të ecurisë së punës së studentëve të ekselencës gjatë kryerjes së detyrës dhe vlerësimit të impaktit të kontributit të tyre në cilësinë e shërbimit civil.

Si indicie thelbësore për kryerjen e këtyre vlerësimeve, kanë shërbyer edhe detyrat e lëna nga Kuvendi, në rezolutën e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për vitin 2020.

⇒ **Procesin e vlerësimit të impaktit të ligjit për nëpunësin civil**, për gjithë periudhën e aplikimit të tij, Komisioneri e ka realizuar duke kërkuar mendim nga njësitë e burimeve njerëzore, të cilat janë subjektet që realizojnë administrimin e shërbimit civil dhe që kanë

një njohje më të thellë të ligjit dhe proceseve që ndodhin gjatë administrimit, e po kështu, i është drejtuar edhe vetë nëpunësve civilë, si target grupi që përfiton në mënyrë direkte mbrojtje specifike nga ky ligj, në formën e garancive që i jepen gjatë kryerjes së detyrës.

Konkretisht, ky proces është realizuar nëpërmjet shpërndarjes së një pyetësori në rrugë elektronike në **200** institucione të administratës publike me tipologji të ndryshme, duke përfshirë si kampion të gjithë nëpunësit e kategorisë së nivelit të lartë drejtues, nëpunësit e kategorisë së nivelit të mesëm drejtues; nëpunësit e kategorisë së nivelit të ulët drejtues, si dhe **10%** të nëpunësve të kategorisë së nivelit ekzekutiv.

Me kënaqësi Ju raportoj, se vlerësimi i tyre, në **mbi 90% të rasteve**, nga **1055** nëpunës civilë të anketuar, është se ata ndjehen të mbrojtur prej ligjit dhe se përmbajtja e tij, siguron parimet e meritokracisë, integritetit dhe paanësisë politike në shërbimin civil, duke ndikuar në rritjen e nivelit të cilësisë në shërbimin ndaj qytetarëve.

Nga ana tjetër, dua të theksoj edhe faktin se, ky proces, ka nxjerrë në pah edhe një sërë problemesh që konstatohen gjatë zbatimit në praktikë të këtij ligji, si edhe nevojën për ndryshime në të gjithë bazën ligjore që rregullon administrimin e shërbimit civil, duke dhënë edhe propozime konkrete për zgjidhje, të cilat do të jenë në qendër të vëmendjes së grupit të posaçëm të punës, të ngritur me përfaqësues të Komisionerit dhe të Departamentit të Administratës Publike, i cili po punon për hartimin e raportit dhe draftit të ligjit që do të ndjekë procedurën për miratimin e ndryshimeve ligjore.

⇒ Procesin e **vlerësimit të impaktit të ekselencës** në shërbimin civil, Komisioneri e ka realizuar pasi ka analizuar të dhënat e raportuara nga institucionet, gjatë një periudhe afro 3-vjeçare, që nga fillimi i aplikimit të kësaj skeme, në të gjitha tipologjitë e institucioneve. Rezulton se nga rreth **4410** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në **500** prej tyre janë punësuar studentë të ekselencës me kontratë, nga të cilët, **52%** i janë nënshtruar procedurave të konkurrimit dhe **154** ose **30.8%** të tyre kanë përfituar statusin e nëpunësit civil dhe **105** prej tyre ose **21%** në momentin e raportimit vijonin periudhën e provës.

Konstatohet se në **87 raste** ose **53.7%**, studentët e ekselencës janë vlerësuar në nivelin 1 “shumë mirë”, në **64 raste** ose **39.5%**, në nivelin 2 “mirë” dhe vetëm në **1 rast** ose **0.6%**, është aplikuar niveli 3 “kënaqshëm”. Kjo dëshmon për një performancë shumë të mirë të këtyre studentëve, gjë që mbështetet edhe nga opinionet e dhëna nga vetë institucionet në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, duke i cilësuar këta studentë si vlerë e shtuar në institucionet e tyre.

⇒ Për të realizuar procesin e vlerësimit të **impaktit të pozicioneve të paplotësuara** në sistemin e shërbimit civil, në performancën e administratës publike, Komisioneri kërkoj informacion nga **116** institucione të administratës publike të tipologjive të ndryshme në shërbimin civil. Nga analiza e informacionit rezultoi se për periudhën 2019-2021, mesatarisht rreth **15.5%** të pozicioneve të punës në shërbimin civil nuk janë plotësuar. Referuar strukturës së këtyre institucioneve, me numrin më të lartë të pozicioneve të paplotësuara, rreth **20%**, paraqiten bashkitë dhe prefekturat.

Vlerësoj se kjo situatë ndikon negativisht në drejtim të realizimit të detyrave institucionale, pasi administrata funksionon me kapacitet të cunguar. Nga ana tjetër, të dhënat e administruara gjatë këtij procesi, si dhe gjatë mbikëqyrjeve të organizuara nga Komisioneri, tregojnë për një planifikim jo të saktë dhe në mënyrë shkencore të nevojave për burime njerëzore.

Për përmirësimin e kësaj situatë vlerësoj se nevojitet një nivel më i lartë bashkëpunimi, midis institucioneve që janë pjesë e shërbimit civil, të tipologjive të ndryshme, për t'u koordinuar midis tyre, me qëllim që të vihen në efikasitet institutet e ligjit, për të cilat nuk ka asnjë pengesë që të përdoren në të gjithë sistemin e shërbimit civil. Pavarësia institucionale nuk ka asnjë cenim, nëse institucionet bashkëpunojnë midis tyre në fushën e shërbimit civil, për aspekte të cilat ligji për shërbimin civil, i tejkalon kufijtë dhe i vlerëson ato si pjesë të një sistemi.

⇒ Po kështu, dua të ndaj me Ju, edhe një proces të rëndësishëm që kemi nisur në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Nëpërmjet një grupi të posaçëm, ka nisur puna për **analizën dhe sjelljen në standardet ligjore të strukturës organizative të institucionit**, por këtë herë jo vetëm nëpërmjet udhëzimeve të përgjithshme, por duke e konkretizuar mendimin me shkrim për secilin subjekt dhe për çdo fazë të procesit, nga ana e Komisionerit.

Në fazën e parë të procesit jemi fokusuar në kornizimin e strukturave të njësive të qeverisjes vendore, brenda standardeve numerike, të njësive të tyre organizative (*drejtori, sektorë*), me qëllim që të evidentohet me saktësi numri i pozicioneve që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë vendore, për të ndihmuar më tej në përlllogaritjet reale të vlerës financiare që kërkon reforma e pagave në shërbimin civil.

Me kënaqësi Ju raportoj, se ky proces është mbështetur nga të gjitha subjektet e përfshira në të. Konkretisht, **mbi 50%** e institucioneve kanë dërguar strukturën paraprake (*draft strukturën*) për mendim pranë Komisionerit dhe institucionet e tjera e kanë dërguar për

vlerësim strukturën, pasi e kishin miratuar atë përpara daljes së udhëzimit, por janë treguar të hapur për ta diskutuar më tej.

Ndërkohë, për të rritur efikasitetin e procesit, po punohet në komunikim të vazhdueshëm edhe me institucionet e tjera që mund të ndihmojnë në këtë drejtim, si Prefekti i Qarkut, Këshillat Bashkiake; Ministria e Brendshme, Agjencia për Çështjet Vendore, DAP, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, të cilët kanë shprehur gatishmërinë e tyre për mbështetjen e Komisionerit në këtë proces.

Gjatë kësaj faze, Komisioneri ka kërkuar pezullimin e të gjitha konkurrimeve me qëllim që të parandalohen proceset e panevojshme, duke përcaktuar paraprakisht pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, e më tej, pas kësaj faze, është dhënë miratimi për të vijuar procesi. Rastet emergjente janë trajtuar menjëherë nga Komisioneri, me qëllim që të mos pengojë puna e institucioneve.

⇒ Një tjetër aspekt i punës së Komisionerit gjatë këtij viti është vlerësimi dhe shqyrtimi i **ankesave / kërkesave / informacioneve**, nëpërmjet inspektimeve. Në **145** raste inspektimesh, procesi ka përfunduar në 118 raste dhe 27 raste të tjera, janë mbartur për t'u trajtuar në vitin 2022, të cilat në momentin e raportimit kanë përfunduar të gjitha.

Vlen të theksohet se numri i informacioneve të ardhura në adresë të Komisionerit, këtë vit është pothuajse konstant, krahasuar me një vit më parë, ku u regjistruan 150 ankesa. Në të gjitha rastet, procesi i inspektimit është përmbyllur me një vendim të Komisionerit, i cili ka ndjekur rrugën e tij të zbatimit, sipas afateve të vendosura në dispozitivin e tij.

⇒ Sa i takon **mbikëqyrjes së përgjithshme dhe tematike**, raportojmë se ky proces është zhvilluar në **13** subjekte me tipologji të ndryshme të institucioneve në shërbimin civil, të planifikuar për t'u kontrolluar në planin vjetor, apo me kërkesë të vetë institucioneve.

Gjatë këtij viti, Komisioneri ka përfshirë në mbikëqyrje dy nga institucionet e krijuara rishtaz në sistemin e drejtësisë, që janë ILD dhe KLP, duke kontrolluar kryesisht procesin e rekrutimit. Në institucionet e tjera, mbikëqyrja është orientuar në disa aspekte të administrimit të shërbimit civil, ndër të cilat: rekrutimi dhe zhvillimi i sistemit të karrierës; hartimi dhe miratimi i formularit të përshkrimit të punës; zbatimi i procedurës gjatë vlerësimit të punës; monitorimi i kontratave të përkohshme në pozicione pune të shërbimit civil.

⇒ Është realizuar procesi i **monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë**

zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, të zhvilluara në 25 prill 2021.

Ky proces ka përfunduar me një raport vlerësimi, ku theksohet fakti se shërbimi civil është duke treguar gjithmonë e më shumë maturi në drejtim të zbatimit të parimit të paanësisë politike, e po kështu duke i ardhur në ndihmë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në rolin e anëtarëve të strukturave të posaçme të ngritura për të realizuar procesin zgjedhor.

Në këto zgjedhje, ka pasur një bazë ligjore më të detajuar për rregullimin e sjelljes së nëpunësve civilë, nëpërmjet një akti të posaçëm të KQZ-së, ku përcaktoheshin qartë kufizimet dhe të drejtat e palëve. Komisioneri ka dhënë orientime në rastet kur janë evidentuar paqartësi, apo është kërkuar nga institucionet, sidomos për momente të pa rregulluara nga ligji në mënyrë specifike, ndër të cilat edhe pasqyrimi i aktiviteteve zgjedhore në rrjetet sociale. Bashkëpunimi i ngushtë me KQZ-në, ka qenë në qendër të këtij procesi.

⇒ Ka vijuar procesi në drejtim të konsolidimit të bazës së të dhënave dhe zgjidhjes së problemeve që dalin gjatë **ekzekutimit të vendimeve gjyqësore** për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues. Gjatë vitit 2021, ka vijuar të trajtohet situata në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që është edhe institucioni me problematikë më të shtuar në të gjitha institucionet e administratës qendrore dhe në përgjithësi në të gjithë sistemin e shërbimit civil.

Duke krahasuar të dhënat sipas fazave të ndryshme të procesit, në periudha të ndryshme kohore, rezulton se deri në datën 30.05.2019, kishte mundur të ekzekutonte vetëm **44** nga **187** vendime gjyqësore që kishin marrë formë të prerë në atë moment, ose **23%** të rasteve, ndërsa deri në datën 31.12.2021, janë ekzekutuar **231** vendime, nga **295** vendime gjyqësore të formës së prerë ose **78%** e rasteve. Ashtu si duket nga të dhënat, edhe pse numri i vendimeve për ekzekutim është rritur, është rritur ndjeshëm edhe numri i vendimeve të ekzekutuara. Ky fakt vlerësohet nga Komisioneri si një arritje që duhet evidentuar në favor të ecurisë së mirë të këtij procesi.

Vlerësoj se ka një progres të dukshëm të situatës së **ekzekutimit të vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë**, në fushën e rikthimit në punë të nëpunësve gjyqfitues në përgjithësi, pasi tashmë janë evidentuar të gjitha vendimet gjyqësore; janë regjistruar gjyqfituesit në listën e pritjes; janë duke u zbatuar detyrimet financiare si edhe po bëhen përpjekje për emërimin e tyre në një pozicion në shërbimin civil ku ata i plotësojnë kërkesat specifike.

Komisioneri çmon se, vijojnë të mbeten problem pengesa, si të natyrës financiare, ashtu edhe me karakter tekniko ligjor, të krijuara për shkak të mangësive dhe paqartësive në dispozita të veçanta të ligjeve që aplikohen gjatë zbatimit të vendimeve gjyqësore, të cilat kanë nevojë që të rishikohen e të plotësohen, me qëllim që të ndihmojnë ecurinë e procesit dhe të mos krijojnë hapësira për qëndrime subjektive.

Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Komisionerin, është duke punuar për paraqitjen pranë Kuvendit të draftit për ndryshime në dispozitën që rregullon këtë aspekt të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mundësohet ecuria normale e procesit për të sistemuar gjyqfituesit në shërbimin civil.

⇒ Është realizuar mbikëqyrja e orientuar në lidhje me rekrutimet, për **700** pozicione pune pranë DAP duke monitoruar procedurat e konkurrimit për rekrutimin në grup, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë në administratën shtetërore, për **487** pozicione pune, si edhe zbatimin e listës së fituesve të konkurrimeve të mëparshme, listës së pritjes për shkak të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe të emërimeve nga transferimet e përhershme në përfundim të pezullimit për **113** raste.

Rezulton se vijon të mbetet evidente nevoja për zgjerim të grupit të rekrutimit, me sa më shumë pozicione pune të nivelit ekzekutiv me tipare të njëjta, me qëllim që të rritet eficientia e konkurrimit si dhe të respektohet parimi i meritokracisë. Nga, **171** procedura konkurrimi të përfunduara në zbatim të planit vjetor për vitin 2021, në nivelin ekzekutiv, në **66** raste (*që përbëjnë 38.5% të shpalljeve të përfunduara*) procedura e konkurrimit është zhvilluar për një pozicion të vetëm dhe jo grup pozicionesh. Krahasuar me një vit më parë, ku plotësimi në këtë mënyrë zinte rreth 85% të shpalljeve të përfunduara për nivelin ekzekutiv, situata ka një përmirësim të ndjeshëm në favor të zbatimit të qëllimit të ligjit.

Nga ana tjetër, vijon të evidentohet problemi i rekrutimit në grup në administratën vendore dhe në institucionet e pavarura, pasi në këto institucione, vakancat krijohen për një numër të kufizuar pozicionesh, e për pasojë pengohet objektivisht organizimi i “*rekrutimeve në grup*” për pozicionet e nivelit të hyrjes. Mbetet si shqetësim, mungesa e kandidatëve për të konkurruar në pozicione pune të shërbimit civil, të shpallura për t’u plotësuar nëpërmjet konkurrimit, sidomos në bashkitë e nivelit të dytë e vijues si dhe në institucionet e pavarura, në të cilat rekrutimet janë zhvilluar me një numër shumë të ulët të pjesëmarrjes.

⇒ Është realizuar mbikëqyrja e orientuar në lidhje me monitorimin e procesit të lirimit nga shërbimi civil të punonjësve që kanë plotësuar moshën për të dalë në **pension të plotë pleqërie**, si detyrë e veçantë, e ngarkuar nga Kuvendi.

Gjatë vitit 2021, është komunikuar me **184** institucione, që përfaqëson një shifër në rritje në krahasim me një vit më parë (**173** institucione).

Janë evidentuar **219** raste kur punonjësit kanë plotësuar moshën për të dalë në pension (*viti 2020 ka pasur 171 raste*), nga të cilat rezulton se në **150** raste ose **68.5%** të tyre, është përfunduar marrëdhënia e punësimit në shërbimin civil, ndërsa rastet e tjera janë në proces të rikthimit të ligjshmërisë në zbatim të afatit të lënë në vendimet paralajmëruese, ose punonjësit e kanë plotësuar moshën për pension të plotë pleqërie në muajin dhjetor 2021.

Krahasuar me një vit më parë, rezulton se është rritur numri i zbatimit vullnetar të rasteve që kanë plotësuar moshën për të përfituar pension të plotë pleqërie, nga **34 raste** një vit më parë, në **134 raste** gjatë vitit 2021.

⇒ Sa i takon procesit të verifikimit të **zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit** pas përfundimit të afatit të paralajmërimit, si për subjektet e mbikëqyrura, ashtu edhe për inspektimet individuale të lidhura me trajtimin e ankesave të nëpunësve civilë, raportojmë se:

Ky proces është realizuar për **41** institucione dhe në përfundim të verifikimit, rezulton se detyrat e lëna nga Komisioneri janë zbatuar plotësisht nga **28** institucione ose **68%** të tyre dhe në **13** raste ose **32%** të tyre procesi është duke vijuar në faza të ndryshme të tij.

Në procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, janë përfshirë edhe **22** raste individuale, të ankesave të zgjidhura me vendim paralajmërimi dhe në përfundim të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit, procesi është përmbyllur, pasi të gjitha institucionet i kanë zbatuar plotësisht detyrat. Në këto kushte nuk ka qenë nevoja për të përdorur mjetin e gjobës.

⇒ Ka vijuar **pjesëmarrja e Komisionerit në 45 procese gjyqësore**, në të gjitha rastet kur është thirrur nga gjykata si palë në pozita të ndryshme procedurale. Rekomandimet e Komisionerit, apo parashtrimet drejtuar gjykatës, janë vlerësuar të drejta dhe vlerësimi i punës së Komisionerit nga ana e gjykatave, ka ardhur gjithmonë në rritje, pasi në **99%** të rasteve, është lënë në fuqi vendimmarrja e Komisionerit.

⇒ Përpos veprimtarisë së institucionit në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri ka pasur në fokus të punës së tij edhe bashkëpunimin me institucionet e tjera të administratës publike, që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, luajnë

një rol të rëndësishëm në zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil.

1. Në vijim të bashkëpunimit midis dy institucioneve, Komisioneri ka nënshkruar në datë 11.11.2021, një memorandum mirëkuptimi me Departamentin e Administratës Publike, që ka për qëllim zbatimin e unifikuar të legjislacionit për nëpunësin civil në të gjitha institucionet e administratës publike pjesë e tij, nëpërmjet rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit, bashkërendimit të aktiviteteve të përbashkëta, shkëmbimit të të dhënave, unifikimit të praktikës administrative gjatë aplikimit të instituteve të këtij legjislacioni, si dhe ofrimit të ekspertizës së nevojshme për zgjidhjen e problematikave.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i bashkëpunimit midis dy institucioneve tona është edhe ngritja e një grupi të përbashkët pune për identifikimin e plotë të aspekteve që kanë nevojë për ndryshime ligjore, e mandej materializimin e tyre në propozime konkrete të cilat në përfundim do t'i përcillen Kuvendit të Shqipërisë sipas procedurave të parashikuara me ligj.

2. Organizimi i trajnimeve të përbashkëta me ASPA-n për Njësitë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të pushtetit vendor, për të siguruar unifikimin e praktikave, në përputhje me detyrat dhe udhëzimet e Komisionerit. Ky bashkëpunim është realizuar me sukses nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Shkollës Shqiptare për Administratën Publike. Në 17 dhjetor 2021 është mbyllur kursi i plotë i trajnimit "online" "*Zbatimi i ligjit për shërbimin civil në nivel vendor*", me target grup punonjësit e burimeve njerëzore në Njësitë e Qeverisjes Vendore (*bashki*).

Këto ishin disa aspekte të veprimtarisë së Komisionerit gjatë vitit 2021. Gjej rastin të informoj Kuvendin, se edhe gjatë vitit 2022, Komisioneri është duke punuar me të gjitha mundësitë e tij, duke e fokusuar veprimtarinë në realizimin e kompetencave ligjore për të mbikëqyrur zbatimin e ligjshmërisë gjatë administrimit të shërbimit civil.

Siç e përmenda edhe më herët, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka respektimi i standardeve gjatë strukturimit të institucioneve të administratës vendore, Komisioneri e ka vlerësuar si prioritet të punës së tij gjatë vitit 2022, nëpërmjet pjesëmarrjes me veprime konkrete në këtë drejtim, për të arritur rezultate reale në përcaktimin e saktë të numrit të nëpunësve civilë në administratën vendore, si edhe në qartësimin e pozicionimit të vendeve të punës në raport me shërbimin civil.

Po kështu, një tjetër prioritet i veprimtarisë së Komisionerit gjatë këtij viti, mbetet

monitorimi i vazhdueshëm dhe nxitja e subjekteve që përfshihen në sistemin e shërbimit civil për popullimin me të dhëna të platformës së bashkëpunimit administrata.al, e cila do të sjellë zhvillime të qenësishme në drejtim të unifikimit të zbatimit të ligjit dhe njëkohësisht do të ndihmojë edhe Komisionerin për të mbikëqyrur në kohë reale administrimin e shërbimit civil në këto institucione.

Në planin e punës për vitin në vijim është përfshirë edhe procesi i mbikëqyrjes dhe hetimit administrativ të ankesave që vijnë në drejtim të Komisionerit, që kanë lidhje me aspekte të ndryshme të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil.

Komisioneri do të vijojë veprimtarinë e tij, në drejtim të këshillimit dhe ndihmës së institucioneve për të zbatuar drejt ligjin, çka është një përvojë tashmë e krijuar, e cila do të realizohet nëpërmjet asistencës teknike përmes stafit të tij, drejtuar tek njësitë përgjegjëse në administrimin e shërbimit civil, në këto institucione.

Kjo punë e nisur, do të vijojë me këshillimin e njësisë përgjegjëse gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të strukturave finale, si dhe gjatë hartimit dhe miratimit të përshkrimit të punës, në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Komisioneri do të vijojë të punojë për të ndihmuar në të gjitha aspektet që kanë lidhje me ecurinë e reformës në administratën publike, duke dhënë kontributin e tij në kuadër të zhvillimit të strategjive ku ai ndërvepron së bashku me aktorët e tjerë.

Në fund por jo për nga rëndësia, nisur nga shqetësimi i ngritur gjatë seancës së zhvilluar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në lidhje me cilësinë e juristëve në institucionet e administratës shtetërore, Komisioneri angazhohet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë monitorimit të procesit të rekrutimit të kësaj kategorie nëpunësish nga ana e Departamentit të Administratës Publike dhe njëkohësisht në drejtim të koordinimit të punës ndërmjet DAP-it dhe ASPA-s, për trajnimin e vazhdueshëm të juristëve që tashmë ushtrojnë funksionet e tyre pranë këtyre institucioneve.

Duke ju falënderuar për mbështetjen e vazhdueshme dhe për vëmendjen tuaj, dëshiroj të rikonfirmoj edhe një herë gatishmërinë e institucionit të Komisionerit, për të bërë më të mirën në misionin që i është ngarkuar.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha